



“Diversifikimi i zërave në gazetari”
Grante mediale
Udhëzime për aplikantët

Pse kjo thirrje?

Kosovo 2.0 (K2.0) është medie me bazë në Prishtinë, e përkushtuar në prodhimin e gazetarisë shpjeguese dhe kontekstuale, ku rrëfimtaria nuk ka të bëjë vetëm me dokumentimin e botës përreth nesh, por edhe kontribuon në riimagjinimin e saj.

E themeluar në vitin 2010 si platforma e parë e blogjeve në Kosovë, K2.0 u zgjerua dhe u konsolidua si një zë kritik dhe i besueshëm gazetaresk në vend e përtej. Përgjatë viteve, K2.0 ka botuar një varg revistash të shtypura, përpara se të kalonte në një model të revistës online. Vazhdimisht kemi organizuar një gamë të larmishme ngjarjesh publike dhe nismash për edukimin joformal, të cilat i shohim si qenësore për misionin tonë më të gjerë gazetaresk.

Në janar 2023, filluam zbatimin e projektit [“Diversifikimi i zërave në gazetari”](#), projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, që synon promovimin e pluralizmit medial në Kosovë, [luftimin e dezinformimit](#) dhe ndërtimin e kapaciteteve të mediave, rinisë dhe gazetarëve/eve të rinj/eja që angazhohen në prodhimin e përmbajtjeve gazetareske, të cilat u përmbahen standardeve më të larta profesionale.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje veçanërisht, ne dëshirojmë të ofrojmë **mbështetje financiare dhe trajnime në shkallë të vogël** për mediet dhe organizatat relevante, për t'u ndihmuar t'i realizojnë projektet e tyre mediale inovative e cilësore. Kjo për shkak që duam të sigurohemi se financimi dhe shkathtësitë mund ta arrijnë një audiencë më të larmishme të medieeve dhe organizatave që prodhojnë përmbajtje mediale, të cilat hasin në vështirësi për t'u qasur drejtpërdrejt në fondet e BE, ose ato që ende kanë nevojë t'i rrisin shkathtësitë e tyre gazetareske ose kapacitetin organizativ. Në K2.0, ne besojmë se pluralizmi medial dhe cilësia gazetareske janë qenësore për shëndetin e demokracisë së Kosovës.

Objektivi ynë i përgjithshëm është të mbështesim gazetarinë cilësore dhe me interes publik, si dhe të të kuptuarit dhe besimin e profesionistëve të gazetarisë, medias dhe publikut ndaj gazetarisë së pavarur dhe funksionit të saj të pazëvendësueshëm demokratik.

Përveç mbështetjes së një game të llojllojshme të prodhimeve gazetareske që janë të nënperfaqësuar dhe kanë cilësi të lartë, **qëllimi ynë është të fuqizojmë pjesëmarrësit e përzgjedhur në sigurimin dhe menaxhimin e duhur të projekteve që bazohen në donatorë.** Kjo arrihet përmes kombinimit të sesioneve trajnuese dhe përvijës praktike. K2.0 do të jetë përkrah grantmarrësve gjatë gjithë zbatimit të projektit, duke i udhëzuar ata t'i arrijnë standardet



më të larta në menaxhimin e projektit, burimet njerëzore, raportimin, financat dhe administrimin. Objektivi përfundimtar është që përfituesit e grantit të pajisen me aftësitë e nevojshme për t'u qasur dhe menaxhuar me sukses grante në të ardhmen si dhe ato më të mëdha, duke rritur kështu qëndrueshmërinë e tyre financiare.

Për këtë arsye, aplikantët e përzgjedhur, pavarësisht nga madhësia e grantit, duhet të parashikojnë monitorim nga afër të K2.0 gjatë gjithë zbatimit të projektit të tyre. Varësisht nga përvoja paraprake, këtu mund të përfshihet punë e konsiderueshme në raportimin narrativ dhe financiar, si dhe përditësim për burimet njerëzore, politikat dhe praktikën e prokurimit dhe kontabilitetit.

Kë po kërkojmë?

Kjo thirrje si synim kryesor ka mediet e angazhuara në shoqëri dhe organizatat që prodhojnë produkte mediale, me vëmendje të veçantë ndaj organizatave me bazë në komunitet dhe grupeve që angazhohen në forma inovative për të prodhuar produkte multimediale. Për t'u kualifikuar, aplikantët duhet të jenë:

1. organizatat mediale ose organizatat me kapacitet, arsye ose përvojë të dëshmuar në prodhimin e përmbajtjeve mediale;
2. me seli dhe që veprojnë në Kosovë;
3. të regjistruara si OJQ ose subjekt medial privat.

Mund të aplikojnë edhe nismat e paregjistruara, me kusht që një OJQ e regjistruar ose medie private të funksionojë si sponsor fiskal. Kjo nënkupton që një subjekt i regjistruar, që përmbush kriteret, ndërmerr përsipër të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare sipas qëllimeve të kësaj thirrjeje në emrin e një nisme të paregjistruar, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit.

Vetëm subjektet e medieve private, që janë të vogla për nga madhësia, kanë të drejtë për financim. Për qëllimin e kësaj thirrjeje, një subjekt i vogël medial është një që ka deri në 15 njerëz të punësuar.

Aplikantët mund të aplikojnë në konsorciume deri në tri subjekte të ndryshme (përfshirë sponsorët fiskalë).

Pasi t'i dhurohet një grant, subjekti specifik nuk mund të ri-aplikojë ose të marrë fonde shtesë në kuadër të këtij aktiviteti.

Me grantet tona për mediet, duam t'u japim përparësi subjekteve që kanë potencial të lartë, por që zakonisht përjashtohen nga financimi në këtë fushë. Kjo do të thotë që nëse organizata, media ose subjekti juaj është ende në hapat e parë, apo vendndodhjen e ka jashtë Prishtinës,



ose puna juaj bazohet në një regjion të caktuar dhe drejtohet kah një komunitet, ju inkurajojmë fuqishëm të aplikoni.

Çfarë lloj aktiviteteash duam të mbështesim?

Aktivitetet e pranueshme për këtë thirrje janë **prodhimet gazetareske**, si: artikujt e shkruar, prodhimet multimediale, episode podcastësh, video-prodhimet, prodhimet e dokumentarëve, emisionet e radios, shfaqjet televizive, animacionet dhe prodhime të tjera inovative mediale.

Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se aktivitete të tilla si diskutime, konferenca, etj. **nuk janë të pranueshme** në këtë thirrje. Gjithsesi, aktivitetet jo-gazetareske mund të konsiderohen të pranueshme nëse ato mund të dëshmojnë si të nevojshme për realizimin e prodhimeve gazetareske. Për shembull, punëtoritë që përfshijnë publikun në gazetari pjesëmarrëse ose sesione trajnimi i gazetarëve/eve të rinj/reja për të prodhuar përmbajtje redaktoriale mund të jenë të pranueshme në këtë kategori, me kusht që prodhimet gazetareske të përbëjnë pjesën më të madhe të aktiviteteve të propozuara.

Për t'i plotësuar kushtet, projektet duhet të realizohen në një periudhë deri **në dymbëdhjetë muaj**.

Po ashtu, aplikantët duhet të tregojnë se si projekti i tyre ka potencialin **për ta arritur në mënyrë efektive** publikun (qoftë publikun në përgjithësi ose kategori të identifikuar mirë të qytetarëve), duke qenë se çështja e publikut në këtë thirrje ka rëndësi qenësore.

Për këtë arsye, rezultatet e projektit duhet të shpërndahen **online**, përkatësisht, në webfaqe ose në platformat e rrjeteve sociale të medieve/OJQ fituese ose në platformat e medieve partnere, kur është e aplikueshme. Për të siguruar shtrirje në publik, aplikantët që nuk janë medie duhet të parashikojnë lidhjen e **partneriteteve me medie** për shpërndarjen e rezultateve të projektit.

Prodhimet gazetareske të financuara nga kjo thirrje duhet të shtyjnë përpara qëllimin e projektit “Diversifikimi i zërave në gazetari”, që do të thotë të jenë të orientuara drejt publikut dhe të përqendrohen kryesisht në përmirësimin e përfaqësimit dhe diversitetit medial, si dhe luftimin e [dezinformimit, çinformimit dhe keginformimit](#). Si rrjedhojë, është e rëndësishme të sqarohet se kjo thirrje nuk i ka si prioritet prodhimet gazetareske që përqendrohen në çrregullimin informativ. Në vend të kësaj, aplikantët inkurajohen **t’i identifikojnë çështjet e rëndësishme për audiencën e tyre të synuar**, veçanërisht ato që rrezikojnë të trajtohen në mënyrë sipërfaqësore ose në mënyrë diskriminuese. Pastaj, ata duhet të propozojnë mënyra për t’i adresuar këto çështje, duke përdorur mjete gazetareske që promovojnë diversitetin në medie, përfshirjen dhe cilësinë.



Me fjalë të tjera, projekt propozimi juaj duhet ta adresojë një boshllëk që është dëshmuar në peizazhin medial kosovar, të synojë t'i kundërshtojë narrativat ekzistuese, që bazohen në informata të pasakta ose jashtë kontekstit, sensacionalizëm ose stereotipe dhe ta sfidojë diskriminimin ose fshirjen e grupeve të cënueshme, të drejtave dhe përvojave të tyre nga diskursi publik. Për më tepër, prodhimet tuaja mediale duhet ta mbështesin një kulturë të të drejtave të njeriut dhe solidaritetit dhe të synojnë t'i vënë në pah çështjet që janë të rëndësishme nga pikëpamja e drejtësisë sociale, të cilat ose tejkalojnë ose trajtohen sipërfaqësisht në mediet kryesore.

Çfarë lloj financimi mund të prisni të merrni?

Në kuadër të këtij raundi, deri në gjashtë aplikantë ose konsorciume aplikantësh do të përfitojnë një grant. Secili projekt fitues mund t'i përfitojë deri në **11,000.00 EUR** financim në kuadër të kësaj thirrjeje. Është qenësore të kuptohet se grantet e ofruara **bazohen në projekte**, jo grante institucionale apo grante financuese për OShC-të. Kjo do të thotë që nëse projekti juaj zgjidhet, sukcesi i tij do të vlerësohet vetëm në bazë të objektivave dhe specifikave të përshkruara në propozimin tuaj.

E kuptojmë se vendosja e kufizimeve të përqindjes së fondeve që aplikantët mund t'i ndajnë për burimet njerëzore ose personelin e brendshëm shpesh nuk u përgjigjet nevojave të medieeve dhe organizatave të lidhura me to. Për këtë arsye, nuk ka ndonjë kufizim në përqindjen e fondeve që mund ta ndani për secilën kategori buxhetore.

Megjithatë, për shkak të madhësisë dhe shtrirjes së granteve tona mediale, presim që buxheti i propozuar nga ju të drejtohet kryesisht, nëse jo ekskluzivisht, **për prodhimin e produkteve gazetareske**.

Më tej, kjo thirrje synon t'i mbështesë projektet në shkallë të vogël, që kanë kuptim më vete. Kjo do të thotë që mund të aplikoni për fonde dhe aktivitete, që plotësojnë projektet ose programet ekzistuese të organizatës suaj. Megjithatë, nëse e bëni këtë, duhet të tregoni në propozimin tuaj se ideja e projektit sjell qartazi vlerë të shtuar projektit ose programit tuaj ekzistues, është relevant në vetvete dhe është i pavarur. Kjo do të thotë gjithashtu se kjo mundësi financimi nuk është e përshtatshme për bashkëfinancimin e vogël të projekteve ekzistuese.

Bashkëfinancimi i buxhetit të projektit me burime të veta ose të palëve të treta lejohet, por nuk kërkohet.

Për më tepër, ne nuk do të mbështesim:

- projekte që lidhen kryesisht me sponsorime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca dhe të ngjashme;



- projekte që kanë të bëjnë me partitë politike dhe/ose fushata politike, ose që vijnë nga aplikantë, që janë të lidhur me partitë politike;
- projektet që janë pjesë e nismave ose programeve më të mëdha të cilat tashmë marrin mbështetje financiare nga Programi IPA për Shoqërinë Civile dhe Medie të Bashkimit Evropian, linja buxhetore: BGUE-B2021-15.020101.01-C1-PREJ DELKOS,

as nuk do të pranojmë t'i mbulojmë financiarisht:

- borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi),
- kostot që bëhen para fillimit të zbatimit të projektit, ose pas përfundimit të tij,
- provizione për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen,
- blerje të tokës ose ndërtesave,
- TVSh, taksa, detyrime dhe tarifa,
- kredi për palët e treta.

Nëse arrini të gjeneroni të ardhura falë zbatimit të projektit tuaj, ai fitim duhet të riinvestohet plotësisht brenda projektit.

Për të gjitha projektet e përzgjedhura, financimi kushtëzohet nga përputhshmëria me [udhëzimet e vizibilitetit të Bashkimit Evropian](#).

Për çfarë lloj trajnimesh do të mund të trajnoheni?

Qëllimi i kësaj thirrjeje është t'u sigurojë aplikantëve përfitues fondet dhe shkathtësitë për t'i përfunduar projektet e tyre inovative mediale. Nëse përzgjidheni, do të merrni pjesë në një program trajnimi në shkallë të vogël të organizuar nga K2.0.

Programi i trajnimit bazohet në përvojën tonë dhjetë-vjeçare në gazetarinë multimediale, të pavarur dhe të [vlerësuar me çmime](#). Dëshirojmë t'u kushtojmë kohë dhe t'i ndajmë me kolegët/et tanë/ona shkathtësitë dhe burimet, që kemi zhvilluar përgjatë viteve, në mënyrë që të mund t'i thelloni njohuritë dhe pasionin tuaj për gazetarinë cilësore, inovative dhe në shërbim të publikut.

Do të jeni pjesëmarrës në tri punëtori trajnuese, duke u përqendruar në:

1. funksionimin dhe rolin e medias së pavarur, duke përfshirë angazhimin e audiencës,
2. mbikëqyrja dhe raportimi i ndjeshëm ndaj të drejtave të njeriut,
3. menaxhimi financiar,
4. menaxhimi i projektit dhe vizibiliteti.

Punëtoritë janë caktuar të zhvillohen, tentativisht, **në qershor 2024**. Të gjithë aplikantët fitues duhet t'i ndjekin punëtoritë, duke siguruar pjesëmarrjen e të paktën një anëtar të personelit përkatës në çdo punëtori.



Si të aplikoni?

Për t'u konsideruar për mbështetje financiare, duhet të dërgoni dosjen tuaj të aplikimit në:
<eumediagrants@ktwopointzero.com>

Afati i fundit për të paraqitur aplikimin tuaj është **21 prill 2024**. Për të siguruar drejtësi, **ne nuk do të pranojmë aplikime që dorëzohen pas afatit ose t'u lejojmë të shtoni apo të zëvendësoni dokumentet që mungojnë ose janë të pasakta pas afatit.**

Që të shqyrtohet, aplikacioni juaj duhet të përmbajë:

1. projekt propozimi,
2. propozimi i rezultateve dhe objektivave të shtrirjes,
3. propozimi buxhetor,
4. dëshmi të regjistrimit të aplikantit kryesor (nëse jeni OJQ ose medie private, ose të subjektit që vepron si sponsor fiskal nëse jeni një nismë e peregjistruar) dhe partnerëve, nëse ka,
5. dëshmi tatimore të aplikantit kryesor (dhe partnerëve, nëse ka), jo më e vjetër se tre muaj nga afati i fundit për aplikime.

Shabllonet për projekt propozimin tuaj, propozimin e rezultateve dhe objektivave të shtrirjes dhe propozimin buxhetor janë të bashkangjitura në këtë thirrje. Ju duhet t'i përdorni këto modele dhe **t'i plotësoni ato në tërësi** nëse dëshironi që ta shqyrtojmë propozimin tuaj. **Dështimi në plotësimin e ndonjëres prej rubrikave të projekt propozimit tuaj ose dështimi në dhënien e informacionit të plotë mund të çojë në skualifikimin e aplikimit tuaj.**

Ngjashëm, për propozimin buxhetor, të gjitha kolonat e shabllonit, duke përfshirë kolonën e arsyetimit, duhet të plotësohen. Modeli për buxhetin përmban **udhëzime shtesë**, për shembull, mbi buxhetimin e duhur dhe shpjegimin e kostove të personelit. **Mosrespektimi i udhëzimeve buxhetore gjithashtu mund të rezultojë në përjashtim nga shqyrtimi.**

Të gjitha dokumentet e aplikimit duhet të dërgohen në formatin *word*, *excel* ose *pdf*. Është përgjegjësi e juaja të siguroheni që na keni dërguar dokumente që mund të lexohen dhe hapen, përndryshe rrezikoni të përjashtoheni. **Është gjithashtu përgjegjësi vetëm e juaja të siguroheni që të jepni informacion të plotë, të saktë dhe në përputhje me udhëzimet në aplikacionin tuaj të projektit.**

Secili subjekt mund të paraqesë, individualisht ose si pjesë e një konsorciumi, **vetëm një propozim**. Nëse dorëzoni ose jeni pjesëmarrës në më shumë se një propozim, të gjitha propozimet në të cilat jeni të përfshirë do të refuzohen.



Aplikimin mund ta shkruani në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Për ta bërë më të lehtë vlerësimin tonë, preferojmë të marrim aplikacione në gjuhën angleze. Pavarësisht kësaj, gjuha që përdorni në aplikim nuk do ta ndikojë vlerësimin e aplikacionit tuaj.

Nëse vendosni ta shkruani aplikimin tuaj në anglisht, jemi të vetëdijshëm se, me shumë gjasë, gjuha angleze nuk është gjuha juaj amtare. Për këtë arsye, për aq sa propozimi juaj është mjaft i qartë, nuk duhet të shqetësoheni për nivelin e gjuhës angleze.

Ju lutem të keni parasysh se nëse zgjidheni për të përfituar grant, procedurat administrative të granteve do të bëhen në anglisht. Kjo përfshin edhe komunikimin me K2.0 dhe raportimin për projekt.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me thirrjen, mund t'i drejtoni tek eumediagrants@ktwopointzero.com deri më **14 prill 2024**.

Për arsye të paanësisë dhe transparencës, ju lutemi ta keni të qartë se **nuk mund t'iu ofrojmë komente mbi përmbajtjen e propozimit tuaj përpara dorëzimit**.

Si do ta vlerësojmë propozimin tuaj?

Propozimi juaj do të vlerësohet sipas kritereve të mëposhtme:

1. Relevanca e propozimit me objektivat e thirrjes dhe nevojat e grupeve të synuara, duke përfshirë inovacionin (30 pikë max)
2. Efektiviteti dhe realizueshmëria e veprimit të propozuar (maksimumi 20 pikë)
3. Kapaciteti financiar, kapaciteti operacional dhe përvoja e aplikantit (maksimumi 20 pikë)
4. Qartësia logjike e intervenimit, përfshirja e palëve të interesuara, monitorimi dhe vlerësimi (maksimumi 10 pikë)
5. Përfshirja e grupeve të ndjeshme dhe integrimi gjinor (5 pikë max)
6. Qëndrueshmëria (5 pikë maksimumi)
7. Buxheti dhe efektiviteti i kostos (maksimumi 10 pikë)

Propozimi juaj do të vlerësohet nga juria e përbërë nga dy anëtarë/e të ekipit të K2.0 dhe një vlerësues/e i/e jashtëm/me.

Përderisa cilësia e propozimit tuaj mbetet mjete themelor i vlerësimit, juria do t'i kushtojë gjithashtu vëmendjen e duhur **llojlojshmërisë gjeografike dhe tematike** të granteve dhe organizatave që aplikojnë. Parimet e **mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirjes** do të promovohen në mënyrë aktive gjatë procesit të përzgjedhjes. Kjo përfshin marrjen parasysh të skemave të kaluara të nëngranteve të zbatuara nga K2.0 dhe peizazhin objektiv në të cilin veprojnë organizatat aplikuese. Gjithashtu, juria do të bëjë përpjekje ta shmangë financimin e dyfishtë të subjekteve që tashmë marrin mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian.



Duke ndjekur të njëjtin parim, juria do të përpiqet të arrijë një barabarësi midis subjekteve mbështetëse të medias dhe OJQ apo nismave të peregjistruara.

Ju lutemi kini parasysh se, nëse projekti juaj zgjidhet, ne mund t'iu kërkojmë ta ndryshoni propozimin tuaj për t'i përfituar fondet. Kjo mund të ndodhë, për shembull, për ta përmirësuar efektivitetin e kostos së projektit tuaj, për ta përmirësuar logjikën e intervenimit ose për ta rritur ndikimin e aktiviteteve tuaja.

Pavarësisht nëse projekti juaj është përzgjedhur apo jo, **do t'iu njoftojmë për vendimin përfundimtar lidhur me aplikimin tuaj.** Nëse dëshironi, mund të kërkonit sqarime mbi vendimin e jurisë deri në pesë ditë pune pasi iu është komunikuar.

Nëse nuk ka një gabim të qartë dhe objektiv në vlerësimin e jurisë, që ndikon ndjeshëm në vlerësimin e propozimit dhe mund t'i atribuohet vetëm jurisë (si për shembull gabimisht hedhjen poshtë të një projekt-propozimi të plotë, që konsiderohet i paplotë), vendimet e jurisë nuk janë të hapura për ankesë. Në raste të tilla, është përgjegjësia e aplikuesit të dëshmojë gabimin me prova praktike dhe të pakundërshtueshme.

Afati kohor i kësaj thirrjeje

25 mars 2024	Hapja e thirrjes
14 prill 2024	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave në K2.0
21 prill 2024	Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për grante
Maj, 2024	Informacion për aplikantët lidhur me vlerësimin e aplikimeve të tyre
Maj, 2024	Nënshkrimi i kontratës
Qershor, 2024	Fillimi më i hershëm i zbatimit të projektit
Qershor, 2024	Trajnime për nën-përfituesit e përzgjedhur

Këto udhëzime janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.